



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2774/ 2 prot.,

Datë 10.11.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Shpresa Al*” SHPK dhe anulimin e vendimit të Komisionit Vlerësimit të Ofertave për anulimin e procedurës së prokurimit “*E hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, Marrëveshje kuadër me 1 (një) operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 15 muaj, me Nr. REF-80371-09-18-2023, me objekt: “*Blerje Inerte*”, me fond limit 130.829.660 (njëqind e tridhjetë milion e tetëqind e njëzet e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH ose 1.229.718 (një milion e dyqind e njëzet e nëntë mijë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë) euro pa TVSH, kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë për monedhën euro në datë 18.09.2023 është 106,39, parashikuar për tu zhvilluar në datën 19.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik.

Ankimues:

Operatori ekonomik “*Shpresa Al*” SHPK me Nipt K31321021N, me adresa: rruga “*Urani Pano*”, mbrapa “*Veve Center*” Pallati 11, Kati. 2, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik.
Adresa: Rruga “*5 Maji*”, Tiranë.

Në datën 09.11.2023 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dhe autoritetit kontraktor është protokolluar ankesa me numër elektronik A/2023/3584,

datë 09.11.2023, dhe me nr. 2774/2023 prot, datë 09.11.2023 e operatorit ekonomik “Shpresa AI” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, Marrëveshje kuadër me I (një) operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 15 mujor, me Nr. REF-80371-09-18-2023, me objekt: “Blerje Inerte”, me fond limit 130.829.660 (njëqind e tridhjetë milion e tetëqind e njëzet e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH ose 1.229.718 (një milion e dyqind e njëzet e nëntë mijë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë) euro pa TVSH, kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë për monedhën euro në datë 18.09.2023 është 106,39, parashikuar për tu zhvilluar në datën 19.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Shpresa AI” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:
b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “Shpresa AI” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 2774/2023 prot., datë 09.11.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.5 Kapaciteti Teknik ku parashikohet se: Operatori ekonomik duhet të paraqesi analizën e çmimeve për të gjithë zërat objekt prokurimi pasi OE nuk ka llogaritur zërin orë pune puntori për transportin e artikullit çimento”.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 10.11.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar
Fiorent Zguro**